




Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Home Affairs FDHA  
Federal Office of Public Health FOPH

# Vaksina Ime Mbrojtja Jote

 kundër fruthit dhe kollës së bardhë




Fruthi

## Për mbrojtjen e foshnjave, Zyra Federale e Shëndetësisë Publike njashtu edhe mjekët ju rekomandojnë prindërve vaksinimin kundër fruthit.

Fruthi është një sëmundje infektive shumë ngjitëse, që veçanërisht tek bebet dhe të rriturit mund të çojë deri në komplikime të rënda. Nënave dhe baballarëve pa mbrojtje kundër fruthit (pa vaksinim paraprak ose sëmundje) u rekomandohet që të vaksinohen për mbrojtjen e tyre dhe të bebeve të tyre – për shkak se zakonisht foshnjat tek prej muajit të dymbëdhjetë mund të vaksinohen kundër fruthit.

### Rreziku për foshnjat dhe gratë shtatzëna nga fruthi

Tek foshnjat qëndron një rrezik më i lartë i komplikimeve nga infeksioni i fruthit dhe shkalla e shtrimit në spital është relativisht e lartë. Edhe pse bebet në përgjithësi shërohen mirë, në raste të rralla kjo sëmundje mund të përfundojë edhe me vdekje – kryesisht për shkak të pneumonisë. Shumë rrallë mbetet edhe pas shërimit virusi në trurin e foshnjës dhe shkakton disa vite më vonë një infeksion në tru, që gjithmonë përfundon me vdekje. Nëse një grua shtatzëne sëmuret nga fruthi, për te rritet rreziku nga pneumonia. Nëse gjatë shtatzënisë ndodh një infeksion, mund të vijë deri në një abort spontan, një lindje e parakohshme ose një lindje e foshnjës me peshë të ulët.



### Nënat dhe baballarët mund të bëjnë diçka kundër kësaj

Me një pickim të vogël prindërit mbrojnë vetveten dhe në këtë mënyrë edhe vocërrakët e tyre nga pasojat potencialisht të rënda nga infeksioni i fruthit. Viruset e gjallë që epen në dozë të vaksinës janë të dobëta. Mbrojtja imune aktivizohet, pa u shfaqur sëmundja ose pa ardhur deri te komplikimi i saj. Indikacionet anësore të vaksinimit janë zakonisht të dobëta dhe shumë më pak të rrezikshme se sëmundja. Vaksinimi i plotë mbron më së shumti për gjatë tërë jetës.


### Rekomandimet e vaksinimit për të rriturit:

- ◆ Ripërtëritjen e vaksinimit për të gjithë ata që kanë lindur me 1964 dhe më vonë, të cilët nuk janë vaksinuar dy herë dhe ende nuk e kanë kaluar fruthin; ata që dëshirojnë fëmijë mundësisht vaksinimi para shtatzënisë.


Për siguri paraprake shtatzënat nuk duhet të vaksinohen: Nëse megjithatë ndodhë vaksinimi, nuk ka asnjë arsye për një abort. Rimarrja e vaksinimit mund të bëhet menjëherë pas lindjes.

### Rekomandimet e vaksinimit për foshnjat:

- ◆ Në përgjithësi: doza e parë me 12 muaj dhe e dyta me 15 deri në 24 muaj.
- ◆ Fëmijët të mbikëqyrur në grupe: doza e parë me 9 muaj dhe e dyta me 12 deri në 15 muaj.
- ◆ Në rast të një epidemie: doza e parë prej 9 muaj dhe e dyta me 12 deri në 15 muaj.
- ◆ Në kontakt të drejtpërdrejtë me personin e sëmurë: doza e parë prej 6 muaj, e ndjekur nga dy të tjera, në qoftë se dhënia e dozës së parë ishte para moshës 9 muajsh.

 kundër fruthit dhe kollës së bardhë

# Vaksina Ime Mbrojtja Jote

 Kolla e bardhë


Për mbrojtjen e të porsalindurve, Zyra Federale e Shëndetësisë Publike njashtu edhe mjekët u rekomandojnë prindërve vaksinimin kundër kollës së bardhë.

Kolla e bardhë (Pertussi) është tepër ngjitës dhe transmetohet përmes pikave. Kjo sëmundje manifestohet me kollitje të rënda, që mund të vijë deri tek sulme ngufatjesh të rënda. Për të rriturit kjo sëmundje është zakonisht e padëmshme. Shpesh herë janë prindërit ata, të cilët e bartin këtë sëmundje padije tek fëmijët e tyre. Sulmet e kollitjes mund të zgjasin disa javë dhe fëmijët janë të kufizuar gjatë gjumit, ushqimit dhe frymëmarrjes.

## Rreziku për foshnjat nga kolla e bardhë

Sidomos tek të porsalindurit ose tek foshnjat mund të shfaqen pushime dhe ndërprerje kërcënuese të frymëmarrjes. Komplikime të tjera janë: pneumonia, Infeksionet e veshit të mesëm, sulme ngërçi dhe sëmundje në tru me mundësi të dëmtimit të përvetshëm. Në raste të rralla kjo sëmundje përfundon deri edhe me vdekje. Një trajtim me antibiotikë mund të mbrojë ndaj komplikimeve të kollës së bardhë, vetëm nëse përdoret në ditët e para.

«Një pickim i vogël për mua –  
një mbrojtje e madhe për ty»



Nënat dhe baballarët mund të bëjnë diçka kundër kësaj

Me një therje të vogël prindërit mbrojnë vetveten dhe në këtë mënyrë edhe vocërrakët e tyre nga pasojat potencialisht të rënda nga transmetimi i kollës së bardhë. Indikacionet anësore të vaksinimit janë zakonisht të dobëta dhe shumë më pak të rrezikshme se sëmundja. Si substancë vaksinore e mbytur, vaksinimi është edhe gjatë shtatzënisë i sigurt.

## Rekomandimet e vaksinimit për të rriturit:

- ◆ Rifreskimin i vaksinës për të gjithë mes moshës 25 dhe 29.
- ◆ Të rriturit në kontakt të rregullt me foshnjat nën 6 muaj (ndër këta prindërit, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat), nëse vaksinimi i fundit kundër kollës së bardhë është më gjatë se 10 vite.
- ◆ Shtatzënat, nëse vaksinimi i fundit kundër kollës së bardhë është më gjatë se 5 vite.

## Rekomandimet e vaksinimit për foshnjat:

- ◆ Në përgjithësi: në 3 doza me 2, 4 dhe 6 muaj.
- ◆ Fëmijët e mbikëqyruar dhe foshnjat e parakohshme: me 2, 3 dhe 4 muaj.
- ◆ Rifreskimi i vaksinave: me 15 deri 24 muaj, mosha 4 deri 7 dhe 11 deri 15 vjeç.

Informata të mëtejme:

[www.sichimpfen.ch](http://www.sichimpfen.ch)

[www.myvaccines.ch](http://www.myvaccines.ch)

Vaksinimi-Infoline:

0844 448 448

Për pyetje të mëtejme drejtohuni tek mjeku apo mjekja juaj shtëpiak/e. Këta mund të ju japin informacione.